



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. _____ Regj.

Ballsh, më ____ . ____ . 2021

Lënda: **Formulari i Njoftimit të Fituesit**

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË
(për publikim në SPE dhe buletin e njoftimeve publike)

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
BASHKIA MALLAKASTËR

Data 15.12.2021

Drejtuar: **“GLAVENICA” shpk**, me NIPT K17710805A, me adresë ushtrimi të aktivitetit sipas QKB: Lgj. “5 Shkurti”, Blv. “4 Heronjtë”, Godina nr.2, Ap.nr.3, Kati 1, K.4, BALLSH

* * *

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur”**

Numri i referencës së procedurës: **REF-12186-11-19-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Përmirësim i kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara”**, me fond limit **28,928,485** (njëzetë e tetëmilion e nëntëqind e njëzetë e tetëmijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë) **Lekë pa TVSH**, me afat 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.171, datë 1 Dhjetor 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “2 N” shpk, me NIPT L31615017L, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **23,440,494** (njëzetë e tremilion e katërqind e dyzetmijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH**.

2. **Operatori Ekonomik “2Z KONSTRUKSION” shpk**, me NIPT J63229466K, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **25,934,382** (njëzetë e pesëmilion e nëntëqind e tridhjetë e katërmijë e treqind e tetëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH**.
3. **Operatori Ekonomik “6D - PLAN” shpk**, me NIPT L62717405H, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **24,232,743** (njëzetë e katërmilion e dyqind e tridhjetë e dymijë e shtatëqind e dyzet e tre) **lekë pa TVSH**.
4. **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “ASI-2A CO” shpk**, me NIPT K53002402C & **“GENTI 001” shpk**, me NIPT L93101401U, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **23,657,367** (njëzetë e tremilion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH**.
5. **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “CAUSHI M” shpk**, me NIPT L88419801O & **“SINDER AB” shpk**, me NIPT K01531003W, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **23,225,672** (njëzetë e tremilion e dyqind e njëzetë e pesëmijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH**.
6. **Operatori Ekonomik “EURO-ALB” shpk**, me NIPT K66613407H, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **26,338,010** (njëzetë e gjashtëmilion e treqind e tridhjetë e tetë mijë e dhjetë) **lekë pa TVSH**.
7. **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “GENERAL BETON” shpk**, me NIPT K23013401A & **“JOGI” shpk**, me NIPT J63229478K, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **25,323,273** (njëzetë e pesëmilion e treqind e njëzetë e tremijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre) **lekë pa TVSH**.
8. **Operatori Ekonomik “GLAVENICA” shpk**, me NIPT K17710805A, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **21,769,992** (njëzetë e njëmilion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH**.
9. **Operatori Ekonomik “INA” shpk**, me NIPT J61814009W, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **22,994,999** (njëzetë e dymilion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katërmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) **lekë pa TVSH**.
10. **Operatori Ekonomik “K.M.K” shpk**, me NIPT L78223801E, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **24,945,616** (njëzetë e katërmilion e nëntëqind e dyzetë e pesëmijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) **lekë pa TVSH**.
11. **Operatori Ekonomik “MODESTE” shpk**, me NIPT J62903413B, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **24,863,642** (njëzetë e katërmilion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tremijë e gjashtëqind e dyzet e dy) **lekë pa TVSH**.
12. **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “NGRAÇAN 1934” shpk**, me NIPT J87602809S & **“B93 II” shpk**, me NIPT L52209050O, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **21,388,075** (njëzetë e njëmilion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH**.
13. **Operatori Ekonomik “SHENDELLI” shpk**, me NIPT K07924803N, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **25,671,176** (njëzetë e pesëmilion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH**.

14. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “VELLEZERIT KUKA” shpk, me NIPT J63423440Q & “ZDRAVO” shpk, me NIPT J84003411K, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej 23,212,349.97 (njëzetë e tremilion e dyqind e dymbëdhjetëmijë e treqind e dyzet e nëntë pikë nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyet:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “ASI-2A CO” shpk, me NIPT K53002402C & “GENTI 001” shpk, me NIPT L93101401U, me ofertë ekonomike në shumën prej 23,657,367 (njëzetë e tremilion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatëmijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Formulari i Sigurimit të Ofertës nuk plotëson kushtin e periudhës së vlefshmërisë prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë, siç është përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit. Formulari i Sigurimit të Ofertës që është paraqitur në SPE, është me periudhë vlefshmërie 30 (tridhjetë) ditë, gjë e cila nuk përmbush periudhën e vlefshmërisë së përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit. Gjithashtu, numri i referencës dhe data e tenderit të përcaktuar në Formularin e Sigurimit të Ofertës nuk përputhen me procedurën e këtij prokurimi. Rrjedhimisht nga BOE “ASI-2A CO” shpk & “GENTI 001” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën “2.3.2.”, të kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi anëtarë i BOE “GENTI 001” shpk nuk disponon kategorinë NS-14 A në licencën profesionale të shoqërisë. Rrjedhimisht nga BOE “ASI-2A CO” shpk & “GENTI 001” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.
- Gjithashtu, oferta e paraqitur nuk është sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1, të neni 88, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi ka mospërputhje të pjesës takuese të punimeve që kanë marrë përsipër të realizojnë anëtarët e BOE. Konkretisht, në deklaratën e bashkëpunimit të nënshkruar nga të dy anëtarët, është rënë dakord që “GENTI 001” shpk do të realizojë 10% të punimeve, ndërkohë që në detajimin e bërë në ofertën ekonomike rezulton se nga “GENTI 001” shpk do të realizohen 5% të punimeve. Rrjedhimisht nga BOE “ASI-2A CO” shpk & “GENTI 001” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.

2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “CAUSHI M” shpk, me NIPT L88419801O & “SINDER AB” shpk, me NIPT K01531003W, me ofertë ekonomike në shumën prej 23,225,672 (njëzetë e tremilion e dyqind e njëzetë e pesëmijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën “2.3.8.”, të kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi anëtari i BOE “SINDER AB” shpk nuk disponon certifikatë për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018 ose ekuivalente. Rrjedhimisht nga BOE “CAUSHI M” shpk & “SINDER AB” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.
- Gjithashtu, oferta e paraqitur nuk është sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1, të neni 88, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi ka mospërputhje të pjesës takuese të punimeve që kanë marrë përsipër të realizojnë anëtarët e BOE. Konkretisht, në nenin 13, të akt marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar nga të dy anëtarët, është rënë dakord që “CAUSHI M” shpk do të realizojë 83.33% të punimeve dhe “SINDER AB” 16.67%, ndërkohë që referuar detajimit të bërë në pjesën vijuese të këtij neni, rezulton e specifikuar se të gjitha punimet do të kryhen nga “CAUSHI M” shpk. Rrjedhimisht nga BOE “CAUSHI M” shpk & “SINDER AB” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.

3. Operatori Ekonomik “K.M.K” shpk, me NIPT L78223801E, me ofertë ekonomike në shumën prej 24,945,616 (njëzetë e katërmilion e nëntëqind e dyzetë e pesëmijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, **nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit **dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme** për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën “2.3.8.”, të kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi certifikatat e paraqitura ISO 45001:2018 dhe ISO 14001:2015 nuk janë të vlefshme. Vlefshmëria e këtyre certifikatave ka përfunduar në datën 06.09.2021. Rrjedhimisht nga “K.M.K” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.

4. Operatori Ekonomik “MODESTE” shpk, me NIPT J62903413B, me ofertë ekonomike në shumën prej 24,863,642 (njëzetë e katërmilion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tremijë e gjashtëqind e dyzet e dy) lekë pa TVSH, **nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit **dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme** për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 1/a dhe 2.1., të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7, të dokumentave të tenderit, pasi është konstatuar se Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk është i saktë në të gjitha aspektet. Te Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, në rubrikën B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura, pika 2, të Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit përcaktohet se: “2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;”. Referuar të dhënave të plotësuara në pikën 6, “MODESTE” shpk ka konfirmuar me “PO” se: “Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u

konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;”

Ndërkohë që referuar të dhënave të plotësuara në pikat 8, 9 dhe 10 (ku pikat që kërkohen për deklarim janë të formuluar në formën mohuese), “MODESTE” shpk ka konfirmuar me “JO”.

Sa më sipër, konstatohet se deklarata është e pasaktë në të gjitha aspektet dhe rrjedhimisht nga “MODESTE”, nuk plotësohet kjo kërkesë.

5. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “NGRAÇAN 1934” shpk, me NIPT J87602809S & “B93 II” shpk, me NIPT L522090500, me ofertë ekonomike në shumën prej 21,388,075 (njëzetë e njëmilion e treqind e tetëdhjetë e tetëmijë e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën “2.3.1.”, të kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi nuk plotësohet kushti për përvojën e suksesshme në ekzekutimin e të paktën: (a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, dhe (b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Në paragrafin e dytë, të pikës 3, të nenit 88, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, përcaktohet se: *“Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. ...”*

Referuar fondit limit të kontratës objekt prokurimi (28,928,485 Lekë pa TVSH), për përmbushjen e kushtit (a), nga anëtari lider i BOE, “NGRAÇAN 1934” shpk, i cili ka marrë përsipër të realizojë 51,62% të punimeve, duhej të paraqitej të paktën një punë e ngjashme për një objekt të vetëm në vlerën 14,464,242 Lekë pa TVSH.

Ndërsa për përmbushjen e kushtit (b), nga BOE në raport me përqindjen (%) e marrë përsipër në bashkëpunim duhej të paraqiteshin kontrata të ngjashme ku vlera totale e punëve të kryera të jetë në vlerën 57,856,970 Lekë pa TVSH. Pra, për përmbushjen e kushtit (b), nga anëtari lider i BOE, “NGRAÇAN 1934” shpk, duhej të paraqiteshin kontrata të ngjashme ku vlera totale e punëve të kryera të jetë 51,62% e dyfishit të vlerës limit e kontratës që prokurohet dhe që korespondon me shumën 29,865,767 Lekë pa TVSH.

Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE, nga anëtari lider i BOE, “NGRAÇAN 1934” shpk, për përmbushjen e kësaj kërkesë janë paraqitur këto kontrata:

(1) Kontrata nr.12880/11 prot, datë 05.03.2019, e nënshkruar me Albpetrol Sha, ku pjesëmarrja e “NGRAÇAN 1934” shpk është në raportin 51%, me vlerë koresponduese të kontratës 3,121,840 Lekë pa TVSH.

(2) Kontrata nr.3149, datë 28.09.2018, e nënshkruar me Bashkinë Divjakë, ku pjesëmarrja e “NGRAÇAN 1934” shpk është në raportin 15%, me vlerë koresponduese të kontratës 3,968,204 Lekë pa TVSH.

(3) Kontrata nr.10517/11 prot, datë 02.02.2021, e nënshkruar me Bashkinë Fier, me vlerë kontrate 6,429,981 Lekë pa TVSH.

(4) Kontrata nr.2026 prot, datë 31.07.2018, e nënshkruar me Bashkinë Skrapar, me vlerë kontrate 1,480,000 Lekë pa TVSH.

(5) Kontrata noteriale nr.333 rep, nr.101 kol, datë 09.02.2019, e nënshkruar me subjektin privat F.Z., me vlerë kontrate 12,185,220 Lekë pa TVSH.

Nga sa më sipër, rezulton se nga anëtari lider i BOE “NGRAÇAN 1934”, nuk plotësohet kushti (a), pasi asnjë prej kontratave të paraqitura prej tij, e llogaritur si një objekt i vetëm, nuk është në vlerën 14,464,242 Lekë pa TVSH. Gjithashtu nuk plotësohet as kushti (b), pasi shuma e të gjitha kontratave të paraqitura tij të llogaritura sëbashku nuk plotëson vlerën 29,865,767 Lekë pa TVSH.

Për më tepër, edhe të dy anëtarët e bashkimit të marrë së bashku nuk plotësojnë kushtin (b), pasi vlera totale e kontratave të paraqitura nga të dy anëtarët është 51,222,486 Lekë pa TVSH, ndërsa kushti kërkon plotësimin e vlerës prej 57,856,970 Lekë pa TVSH.

Rrjedhimisht nga BOE “NGRAÇAN 1934” shpk & “B 93 II” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.

6. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “VELLEZERIT KUKA” shpk, me NIPT J63423440Q & “ZDRAVO” shpk, me NIPT J84003411K, me ofertë ekonomike në shumën prej 23,212,349.97 (njëzetë e tremilion e dyqind e dymbëdhjetëmijë e treqind e dyzet e nëntë pikë nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 1/a dhe 2.1., të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7, të dokumentave të tenderit, pasi është konstatuar se Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk është i saktë në të gjitha aspektet. Te Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit, në rubrikën B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura, pika 2, te Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit përcaktohet se: “2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;”.

Referuar të dhënave të plotësuar në pikën 8 (ku kjo pikë që kërkohet për deklaram është e formuluar në formën mohuese), “VELLEZERIT KUKA” shpk ka konfirmuar me “JO”.

Sa më sipër, konstatohet se deklarata është e pasaktë në të gjitha aspektet dhe rrjedhimisht nga BOE “VELLEZERIT KUKA” shpk & “ZDRAVO” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën “2.3.1.”, të kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi për kontratat e ngjashme të paraqitura mungojnë faturat tatimore, si dhe mungon formulari i vlerësimit.

- Gjithashtu, oferta e paraqitur nuk është në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 88, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi nuk është paraqitur kontrata e bashkëpunimit ku përcaktohet pjesa takuese,

përfaqësuesi etj. Rrjedhimisht nga BOE “VELLEZERIT KUKA” shpk & “ZDRAVO” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: **“GLAVENICA” shpk**, me NIPT K17710805A, me adresë ushtrimi të aktivitetit sipas QKB: Lgj. “5 Shkurti”, Blv. “4 Heronjtë”, Godina nr.2, Ap.nr.3, Kati 1, K.4, BALLSH, se oferta e paraqitur, me vlerë totale prej **21,769,992** (njëzetë e njëmilion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109, të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Qerim Ismailaj